

Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave 2017



Përmbajtja

| | | | |
|---|-----------|-------------------------------|-----------|
| Përmbledhje ekzekutive | 4 | Anekset | 16 |
| Metodologjia | 5 | Komuna e Shtimes | 16 |
| Indeksi i transparencës buxhetore komunale | 7 | Komuna e Gjakovës | 18 |
| Krahasim: Indeksi 2016 dhe 2017 | 11 | Komuna e Mitrovicës | 20 |
| Trendi për transparencë buxhetore në 2018 | 13 | Komuna e Prishtinës | 22 |
| Përfundime dhe rekomandime | 14 | Komuna e Prizrenit | 24 |
| | | Komuna e Lipjanit | 26 |
| | | Komuna e Kamenicës | 28 |
| | | Komuna e Drenasit | 30 |
| | | Komuna e Skenderajt | 32 |
| | | Komuna e Istogut | 34 |
| | | Komuna e Suharekës | 36 |
| | | Komuna e Fushë Kosovës | 38 |
| | | Komuna e Hanit të Elezit | 40 |
| | | Komuna e Vitisë | 42 |
| | | Komuna e Malishevës | 44 |
| | | Komuna e Gjilanit | 46 |
| | | Komuna e Rahovecit | 48 |
| | | Komuna e Podujevës | 50 |
| | | Komuna e Kaçanikut | 52 |
| | | Komuna e Dragashit | 54 |
| | | Komuna e Graçanicës | 56 |
| | | Komuna e Klinës | 58 |
| | | Komuna e Pejës | 60 |
| | | Komuna e Vushtrrisë | 62 |
| | | Komuna e Obiliqit | 64 |
| | | Komuna e Ranillgut | 66 |
| | | Komuna e Deçanit | 68 |
| | | Komuna e Shtërpcës | 70 |
| | | Komuna e Junikut | 72 |
| | | Komuna e Mitrovicës së Veriut | 74 |
| | | Komuna e Zubin Potokut | 76 |
| | | Komuna e Novobërdës | 78 |
| | | Komuna e Ferizajit | 80 |
| | | Komuna e Parteshit | 82 |
| | | Komuna e Kllokotit | 84 |

Përmbledhje ekzekutive

Transparenca e plotë buxhetore mundëson përfshirjen e qytetarëve në proceset buxhetore dhe parandalon keqmenaxhimin e parasë publike. Përveç kësaj, transparenca dhe llogaridhënia në menxhimin e buxhetit dhe financave publike rrit besimin në institucione dhe rrjedhimisht të hyrat buxhetore. Duke parë rëndësinë e saj, Instituti GAP, vitin e kaluar ka analizuar legjislacionin dhe ka hartuar një indeks të transparencës buxhetore në nivel komunal. Indeksi i transparencës buxhetore komunale rendit komunat varësisht nga numri i dokumenteve buxhetore të publikuara, dëgjimeve buxhetore me qytetarë, formatin e publikimeve të dokumenteve dhe përgjigjet në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumente buxhetore. Këtë vit, ky raport përdor një indeks të ngjashëm për të vlerësuar gjendjen aktuale dhe për të parë ecurinë e procesit të transparencës buxhetore komunale në vitin 2017. Të gjeturat e këtij raporti tregojnë se krahasuar me vitin 2016, në vitin 2017, indeksi rendit komunat në nivel më të lartë sa i përket transparencës buxhetore. Përderisa në vitin 2016 vetëm 47% e komunave kanë mbledhur mbi 50 pikë në indeks, në vitin 2017 janë 53% të komunave që kanë mbledhur mbi 50 pikë. Sipas formatit të indeksit të vitit 2016, numri i dokumenteve buxhetore për vitin 2017 është 298 apo 13 më i lartë se në vitin 2016.

Përkundër obligimeve ligjore, një numër i konsiderueshëm i komunave vazhdojnë të mos i publikojnë dokumentet buxhetore. Gjithashtu, sipas të dhënave të mbledhura nga 38 komuna, gjithsej 61 (nga 152 dëgjime publike të obliguara me ligj) nuk janë mbajtur. Komunat e Mamushës, Istogut, Vushtrrisë, Ranillugut dhe Deçanit, në vitin 2017 kanë shënuar regres sa i përket transparencës buxhetore. Ndërsa, komunat siç është ajo e Shtimes, Fushë Kosovës, Skenderajt dhe Prishtinës kanë dëshmuar një avancim në këtë aspekt.

Problem tjetër mbetet formati i publikimit të dokumenteve buxhetore. Verzioni MS Excel lejon qasje dhe përdorim më të lehtë të analizimit të të dhënave. Në bazë të të gjeturave të këtij raporti, 55% e dokumenteve janë në formatin MS Excel, 20% në PDF, 17% në formatin PDF i skanuar dhe 8% të dërguara përmes kërkesës.

Për të pasur një vlerësim më të hershëm rreth tendencës së komunave për transparencë buxhetore në 2018, kemi analizuar në këtë raport se sa nga komunat kanë publikuar raportin financiar për trejumorin e parë dhe të dytë dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021 (këto raporte nuk janë pjesë e indeksit për 2017). Po ashtu, kemi analizuar se sa nga komunat kanë publikuar kontratat e nënshkruara gjatë 2017. Përveç përshkrimit të gjendjes së përgjithshme, ky raport ofron edhe vlerësim individual të komunave rreth transparencës buxhetore si dhe paraqet disa rekomandime sa i përket përmirësimit të gjendjes aktuale.

Metodologjia

Indeksi i hartuar nga Instituti GAP për vlerësimin e transparencës buxhetore në komuna në vitin 2017 përbëhet nga 100 pikë të cilat janë të shpërndara nëpër dokumente buxhetore, rregullore, lista të përfituesve të subvencioneve dhe dëgjime buxhetore. Krahas dokumenteve që komunat janë të obliguara ligjërisht që t'i publikojnë, në indeks janë ndarë pikë dhe për dokumente tjera të rëndësishme sikurse Kartelën Analitike të Kontos, listën e përfituesve të subvencioneve dhe raportin e auditorit të brendshëm. Numri i pikëve për një dokument është i njëjtë për të gjitha komunat dhe këto pikë janë vendosur sipas gjykimit të Instituti GAP duke u bazuar në peshën në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në nivelin lokal.

Tabela 1. Vlerësimi me pikë i Komunave për publikimin e dokumenteve sipas Institutit GAP

| Dokumenti | Excel | PDF | PDF i skanuar | Kërkesa |
|---|-------|------|---------------|---------|
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2017 | 5 | 3.5 | 2.5 | 1.5 |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2017 | 5 | 3.5 | 2.5 | 1.5 |
| Raporti financiar TM 3 për vitin 2017 | 5 | 3.5 | 2.5 | 1.5 |
| Raporti vjetor financiar për vitin 2017 | 15 | 10.5 | 7.5 | 4.5 |
| Buxheti i planifikuar për vitin 2018 | 5 | 3.5 | 2.5 | 1.5 |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 | 10 | 7 | 5 | 3 |
| Rregullorja për ndarjen e subvencioneve | 5 | 5 | 5 | 1.5 |
| Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2017 | 10 | 7 | 5 | 5 |
| Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2017 | 20 | 14 | 10 | 10 |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | 2.5 | 2.5 | 2.5 |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | 2.5 | 2.5 | 2.5 |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | 2.5 | 2.5 | 2.5 |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | 2.5 | 2.5 | 2.5 |
| Raporti i auditorit të brendshëm 2017 | 10 | 10 | 10 | 5 |

Në indeksin për vitin 2017, për dallim nga indeksi për vitin 2016, është shtuar dhe raporti i auditorit të brendshëm të komunës me dhjetë pikë, ndërsa është ulur numri i pikëve për dëgjimet buxhetore në 2.5 secili.

Të gjitha dokumentet e publikuara në format të lexueshëm nga kompjuteri siç janë Microsoft Excel apo Word janë vlerësuar me maksimumin e pikëve. Përfundim në këtë kriter bëjnë rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe raportin e auditorit të brendshëm të cilat marrin pikë të njëjta për cilin do format pasi që përmbajtja e tyre është kryesisht tekstuale. Dokumentet e publikuara në formatin PDF janë vlerësuar me 30% pikë më pak, ndërsa publikimi i dokumenteve të skanuara është vlerësuar me 50% pikë më pak. Në rast se një dokument nuk është publikuar fare në faqen zyrtare të komunës, mirëpo komuna është përgjigjur në kërkesën tonë, atëherë kjo është vlerësuar me 70%

pikë më pak. Përjashtim në uljen e pikëve prej 70% për dokumentet e dërguara me kërkesë bëjnë Kartela Analitike e Kontos, raporti i auditorit të brendshëm dhe lista e përfituesve të subvencioneve – kjo për shkak që këto nuk janë ende obligime ligjore për publikim të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Po ashtu, ky indeks nuk bën vlerësimin e cilësisë së dokumenteve të publikuara. Pra, një komunë mund të merr maksimumin e pikëve vetëm në rast se i ka publikuar të gjitha dokumentet në faqen e internetit në formatin Excel dhe ka organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore.

Mbledhja e të dhënave për publikimin e dokumenteve është bërë duke kërkuar nga komunat që të plotësojnë një dokument me linqet/vegzat e dokumenteve të publikuara në faqen e komunës. Kërkesa është dërguar në emailin zyrtar të komunës për komunikim me publikun në tetor 2018, ndërsa monitorimi i faqeve të komunave nga Instituti GAP ka përfunduar gjithashtu në muajin tetor 2018. Për komunat të cilat nuk janë përgjigjur në kërkesën tonë, vlerësimi i indeksit është bërë në bazë të informatave që kemi mundur t'i gjejmë në ueb-faqet e tyre. Në parim, në rast se një dokument nuk gjendet në faqen e komunës me pak klikime, atëherë nuk është marrë parasysh në vlerësim.

E drejta e qytetarëve për qasje në dokumente publike garantohet me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjin për qasje në dokumente publike. Për më shumë, transparenca buxhetore e institucioneve publike rregullohet me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (LMPF), Ligjin për kontroll të brendshëm të financave publike dhe udhëzimet administrative relevante.

Sipas Udhëzimit administrativ të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal (MAPL) për transparencë në komuna, komunat kanë për detyrë t'i publikojnë këto dokumente buxhetore: 1) planin e buxhetit dhe planet investuese; 2) raportet tre mujore të shpenzimeve; 3) kornizën afatmesme buxhetore (KAB); 4) raportin përmbledhës të buxhetit të komunës për vitin e kaluar fiskal; dhe 5) raportin e auditorit të përgjithshëm mbi buxhetin për vitin e kaluar fiskal.¹ Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i bën përgjegjës kryetarët e komunave për publikimin e raporteve tre mujore financiare të cilat duhet të publikohen në ueb-faqen e komunës 30 ditë pas përfundimit të tremujorit.² Ndërsa, Ligji për kontroll të brendshëm të financave publike obligon komunat që të publikojnë raportin e auditimit të brendshëm pesë muaj pas përfundimit të vitit.³

Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, kuvendi komunal është i detyruar të mbajë dëgjime buxhetore me qytetarë, në përputhje me aktet komunale.⁴ Kurse, udhëzimi administrativ i MAPL-së për transparencë në komuna përcakton se komunat përveç obligimit që t'i mbajnë të paktën dy dëgjime publike me qytetarë brenda vitit, duhet të organizojnë takime publike shtesë për buxhet dhe çështje tjera komunale.⁵ Po ashtu, në disa raste qarkoret buxhetore të hartuara nga Ministria e Financave (MF) e obligojnë kryetarin e komunës që të shqyrtojë buxhetin me qytetarë.⁶

1 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Udhëzim administrativ nr. 01/2015 për transparencë në komuna, Neni 4.2. Burimi: <https://bit.ly/2RlJEVv>

2 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 45. Burimi: <http://bit.ly/2h3BfRW>

3 Ligji për kontrollin e brendshëm të financave publike, Neni 16. Burimi: <https://bit.ly/2ABEUQP>

4 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 61.2


5 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Udhëzim administrativ nr. 01/2015 për transparencë në komuna. Burimi: <https://bit.ly/2RlJEVv>

6 Për më shumë detaje rreth bazës ligjore për transparencë buxhetore komunale shih indeksin e vitit të kaluar: <https://bit.ly/2Fkxdzj>

Indeksi i transparencës buxhetore komunale

Rezultatet e indeksit të vitit 2017 pasqyrojnë një nivel jo të kënaqshëm të transparencës buxhetore të komunave. Asnjëra nga komunat nuk ka arritur t'i publikojë të gjitha dokumentet që përbëjnë indeksin. Nga 38 komuna të vlerësuara, më shumë se gjysma e tyre gjenden nën nivelin e 50 pikëve të mbledhura. Mesatarja e pikëve për komunë është 40 pikë, ku disa kanë performuar shumë më mirë në krahasim me disa të tjera. Komunat me numrin më të madh të pikëve të mbledhura janë Shtimja me 85.5 pikë, Gjakova me 71 pikë dhe Mitrovica me 69.5 pikë. Ndërsa Mamusha, Leposaviqi dhe Zveçani janë vlerësuar me 0 pikë ngase nuk kanë publikuar asnjë dokument dhe nuk janë përgjigjur kërkesës së Institutit GAP për qasje në to. Figura 1 paraqet pikët e secilës komunë, ku të hijëzuara janë komunat të cilat kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore të obliguara me ligj.

Figura 1. Indeksi për transparencë buxhetore komunale 2017



Shqetësues mbetet fakti që dokumentet me peshën më të madhe informative për buxhet janë më së paku të publikuara. Vetëm dy nga 38 komunat e Kosovës kanë publikuar “Kartelën Analitike të Kontos” - dokumenti më i detajuar i buxhetit të komunës (Shtime dhe Gjakova). Kurse dy të tjera (Mitrovica e Veriut dhe Hani i Elezit) kanë lejuar qasje në këtë dokument vetëm pas kërkesës së Institutit GAP. Raporti i auditorit të brendshëm është një tjetër dokument me vlerë, të cilin vetëm dy komuna e kanë publikuar. Ndërsa sa i përket dokumenteve me obligim ligjor, 26% apo 10 komuna nuk kanë publikuar fare raportin vjetor financiar për vitin 2017 dhe 39% apo 15 komuna nuk kanë publikuar Kornizën Afatmesme Buxhetore 2018-2020 (Tabela 2).

Tabela 2. Përqindja e komunave që nuk kanë publikuar dokumentet që përmban indeksi


| Dokumentet të cilat nuk janë publikuar | Përqindja e komunave |
|--|----------------------|
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2017 | 34% |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2017 | 29% |
| Raporti financiar TM 3 për vitin 2017 | 39% |
| Raporti vjetor financiar për vitin 2017 | 26% |
| Buxheti i planifikuar për vitin 2018 | 24% |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 | 42% |
| Rregullorja për ndarjen e subvencioneve | 26% |
| Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2017* | 45% |
| Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2017* | 89% |
| Dëgjimi i parë buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 26% |
| Dëgjimi i dytë buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 37% |
| Dëgjimi i tretë buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 42% |
| Dëgjimi i katërt buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 50% |
| Raporti i auditorit të brendshëm 2017* | 95% |

*Dokumentet që nuk janë të obliguara me ligj

Përveç mungesës së publikimit të dokumenteve, pengesë tjetër për analizimin e të dhënave të dokumenteve të publikuara është formati i publikimit. Nga 300 dokumente të analizuar, 55% e tyre janë në formatin MS Excel, 20% në PDF, 17% në formatin PDF i skanuar dhe 8% përmes kërkesës së dërguar.

Komunat me përqindjen më të lartë të publikimit të të dhënave në formatin MS Excel janë Prishtina, Prizreni, Graçanica dhe Novobërda (Figura 2). Ky format mundëson përdorim më të lehtë të të dhënave të buxhetit nga qytetarët. Ndërsa komunat të cilat kanë përqindjen më të lartë të mospublikimit të të dhënave janë Zubin Potoku, Mitrovica e Veriut, Obiliqi dhe Klina. Këto komuna kanë ofruar qasje në disa dokumente vetëm pas kërkesës së Institutit GAP.

Figura 2. Komunat me përqindjen më të madhe të dokumenteve të publikuara në ueb-faqe si ms excel dhe ato me përqindjen më të madhe të dokumenteve të dërguara sipas kërkesës



Gjatë analizimit të të dhënave, vërehet se një numër i madh i komunave kanë bërë të qasshme në ueb-faqet e tyre apo kanë dërguar përmes kërkesës dokumentet si Raporti vjetor financiar për vitin 2017, Buxheti i planifikuar për vitin 2018 si dhe Rregullorën për ndarjen e subvencioneve. Dokumentet e tjera përbërëse të indeksit tregojnë se gjithsej 25 komuna kanë publikuar në ueb-faqet e tyre apo kanë dërguar sipas kërkesës raportin financiar të tremujorit të parë, 27 komuna kanë publikuar ose kanë dërguar sipas kërkesës raportin financiar të tremujorit të dytë dhe 23 komuna kanë publikuar apo kanë dërguar raportin financiar të tremujorit të tretë.

Tek dëgjimet buxhetore, në vitin 2017, janë mbajtur gjithsej 91 takime (Tabela 3). Nga to, pesë komuna kanë ofruar njoftime në ueb-faqe për mbajtjen e vetëm një dëgjimit buxhetor, kurse dhjetë komuna nuk kanë njoftuar fare në ueb-faqe dhe nuk janë përgjigjur kërkesës sonë për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore.

Në anën tjetër, meqenëse nuk është obligim ligjor, publikimi i listave të përfituesve të subvencioneve për vitin 2017 në disa komuna vlerësohet si një hap i mirë drejt një transparence më të madhe. Nga 38 komunat e analizuara, 15 prej tyre kanë publikuar në ueb-faqet e tyre këto lista kurse gjashtë komuna i kanë dërguar sipas kërkesës (Tabela 3).

Tabela 3. Dokumentet e publikuara të indeksit për transparencë buxhetore komunale 2018

| Dokumenti | Pikët | Numri i Komunave | | | |
|--|-------|------------------|---------------|---------|---------------|
| | Excel | PDF | PDF i skanuar | Kërkesa | |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2017 | 9 | 9 | 5 | 2 | 25 |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2017 | 7 | 10 | 6 | 4 | 27 |
| Raporti financiar TM 3 për vitin 2017 | 5 | 10 | 4 | 4 | 23 |
| Raporti vjetor financiar për vitin 2017 | 26 | 1 | 0 | 1 | 28 |
| Buxheti i planifikuar për vitin 2018 | 26 | 1 | 1 | 1 | 29 |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 | 3 | 10 | 6 | 3 | 22 |
| Rregullorja për ndarjen e subvencioneve | 0 | 5 | 22 | 1 | 28 |
| Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2017* | 4 | 7 | 4 | 6 | 21 |
| Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2017* | 1 | 1 | 0 | 2 | 4 |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 83 | 4 | 3 | 1 | 91 dëgjime b. |
| Raporti i auditorit të brendshëm 2017* | 0 | 2 | 0 | 0 | 2 |

*Dokumentet që nuk janë të obliguara me ligj

Krahasim: Indeksi 2016 dhe 2017

Për të krahasuar progresin e bërë nga komunat në rritje të transparencës buxhetore komunale në dy vitet e kaluara, e kemi ruajtur strukturën e indeksit të vitit të kaluar përbrenda indeksit të këtij viti. Krahasuar me vitin 2016, në 2017 indeksi rendit komunat në nivel më të lartë sa i përket transparencës buxhetore. Përderisa në vitin 2016 vetëm 47% e komunave kanë mbledhur mbi 50 pikë në indeks, këtë vit janë 53% të komunave që kanë mbledhur mbi 50 pikë.

Nga komunat të cilat janë vlerësuar në indeksin 2016, progresin më të madh në 2017, bazuar në numrin e pikëve të mbledhura në indeks e kanë bërë komuna e Shtimes, Fushë Kosovës, Skenderajt dhe Prishtinës. Këto komuna e kanë rritur numrin e dokumenteve buxhetore të publikuara në ueb-faqet e tyre. Ndërsa, nga komunat të cilat kanë bërë një hap pas sa i përket transparencës buxhetore në 2017 janë komuna e Mamushës, Istogut, Vushtrisë, Ranillugut dhe Deçanit, duke mos publikuar kështu qoftë numrin e njëjtë të dokumenteve buxhetore ose duke mos organizuar dëgjime buxhetore të paktën sa vitin e kaluar.

Figura 3. Progresi i komunave në transparencë buxhetore 2016-2017





Tabela 4. Indeksi i transparencës buxhetore së Komunave në 2017 në krahasim me 2016

| Komuna | Rangimi 2017 | Rangimi 2016 | Dallimi |
|--------------|--------------|--------------|---------|
| Shtime | 1 | 9 | ▲ 8 |
| Fushë Kosovë | 12 | 26 | ▲ 14 |
| Skenderaj | 9 | 15 | ▲ 6 |
| Prishtinë | 5 | 11 | ▲ 6 |
| Mamushë | 38 | 24 | ▼ 14 |
| Istog | 10 | 1 | ▼ 9 |
| Vushtrri | 24 | 10 | ▼ 14 |
| Ranillug | 26 | 13 | ▼ 13 |
| Deçan | 27 | 21 | ▼ 6 |

Disa studime theksojnë se komunat me popullsi më të madhe janë të prirura të jenë më transparente sa i përket buxhetit.⁷ Nga paraqitja e pikëve të komunave në indeksin e këtij viti kundrejt numrit të popullsisë së tyre në Figurën 4, vërejmë se komunat me numër më të madh të popullsisë në Kosovë janë më transparente. Konkretisht, nga komunat që kanë 50 pikë apo më shumë në indeks, shumica nga to (11 nga 17) kanë mbi 50 mijë banorë. Ndërsa, 15 komuna më me pak se 50 mijë banorë kanë 40 pikë osë më pak në indeks. Rast i veçuar mbetet komuna e Shtimes e cila është komuna më transparente dhe ka më pak se 30 mijë banorë.

Figura 4. Pikët e komunave në indeks në 2017 sipas madhësisë së komunave



7 Shih punimin e Paloma Giménez Perona (2014) "Transparenca buxhetore në qeverisjen lokale". Burimi: <https://bit.ly/2RLnqc>. Ngjashëm, shih punimin e Guillamón et al. (2011) "Përcaktuesit e transparencës buxhetore në qeverisjen lokale". Burimi: <https://bit.ly/2QmODGz>

Trendi për transparencë buxhetore në 2018

Për të pasur një vlerësim më të hershëm rreth tendencës së komunave për transparencë buxhetore në 2018, kemi analizuar në këtë raport se sa nga komunat i kanë katër dokumente të cilat ligjërisht do të duhej të ishin të publikuara nëpër ueb-faqe deri me tani.⁸ Po ashtu, kemi analizuar edhe hapjen e komunave në 2017 sa i përket publikimit të kontratave të nënshkruara. Këto dokumente nuk marrin pikë në indeksin 2017 pasi që do të jenë të përfshira në indeksin e ardhshëm për vitin 2018.

Këtë vit, 29 nga 38 komuna kanë publikuar raportin financiar për tremujorin e parë të vitit 2018. Krahasuar me vitin 2017, janë katër komuna më shumë që e kanë publikuar këtë dokument. Po ashtu, 30 komuna kanë publikuar në ueb-faqet e tyre dhe raportin financiar për tremujorin e dytë në 2018; tre komuna më shumë se në 2017. Këtë vit janë 27 komuna të cilat e kanë publikuar KAB 2019-2021. Në vitin e kaluar (2017), vetëm 22 komuna e kanë publikuar KAB 2018-2020. Në 2017 janë vetëm dy komuna, Fushë Kosova dhe Lipjani, të cilat kanë publikuar kontratat e nënshkruara me operatorët ekonomik. Shumica e komunave tjera nuk i kanë publikuar kontratat ose në ndonjë rast kanë publikuar vetëm raporte përshkruese rreth të gjitha kontratave.

Në përgjithësi, në 2018 vërehet një vullnet më i madh komunave për publikimin e dokumenteve buxhetore. Mirëpo, siç vërehet në tabelën më poshtë, numri i komunave të cilat publikojnë dokumente buxhetore, sikurse raportet financiare tremujore në formatin Excel mbetet i vogël. Andaj, edhe shfrytëzimi i të dhënave nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile apo mediat është më i vështirë dhe merr më shumë kohë.

Tabela 5. Trendi për transparencë buxhetore në 2018 krahasuar me 2017

| | Excel | PDF | PDF i skanuar | Kërkesa | Total 2018 |
|---------------------------------------|-------|-----|---------------|---------|------------|
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2018 | 9 | 10 | 9 | 1 | 29 |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2018 | 9 | 12 | 6 | 3 | 30 |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 | 4 | 11 | 11 | 1 | 27 |
| Kontratat e nënshkruara 2017 | 0 | 0 | 2 | 0 | 2 |

⁸ Pra në kohën e mbledhjes së të dhënave për indeks, konkretisht në tetor 2018.

Përfundime dhe rekomandime

Në vitin 2017, transparenca buxhetore e komunave, e matur sipas indeksit të Institutit GAP, ishte më e lartë se në 2016, pasi janë publikuar një numër më i madh i dokumenteve buxhetore. Nga dokumentet të cilat marrin pikë në indeks, komunat kanë publikuar në ueb-faqet e tyre ose na kanë dërguar përmes postës elektronike sipas kërkesës tonë gjithsej 300 dokumente. Nëse do të ruhej forma e indeksit sikurse vitin e kaluar, pra duke përjashtuar raportin e brendshëm të auditorit, atëherë numri i dokumenteve pjesë e indeksit është 298 apo 13 më shumë se në vitin 2016. Progres në transparencë buxhetore në 2017 kanë bërë komuna e Shtimes, Fushë Kosovës, Skenderajt dhe Prishtinës. Ndërsa, nga komunat të cilat kanë bërë një hap pas sa i përket transparencës buxhetore në 2017 janë komuna e Mamushës, Istogut, Vushtrrisë, Ranillugut dhe Deçanit.

Po ashtu, për dallim nga viti 2016, numri i dokumenteve të publikuara nga komunat në 2017 në verzionin MS Excel, që lejon qasje dhe përdorim më të lehtë të të dhënave, është shumë më i madh. Konkretisht, rreth 55% e dokumenteve janë publikuar në këtë format; në 2016 ishin vetëm 35%. Por, në 2017, numri i dëgjimeve buxhetore të organizuara nga komunat ka mbetur i njëjti (91). Pra, komunat në përgjithësi nuk janë angazhuar për të rritur numrin e takimeve me qytetarë për të diskutuar rreth buxhetit.

Sa i përket trendit të transparencës buxhetore në vitin 2018, vërehet se një numër më i madh i komunave janë duke publikuar raportet financiare tremujore dhe kornizën afatmesme buxhetore relevante për atë vit. Mirëpo, vitin tjetër do të publikohet indeksi që do të analizoji në tërësi transparencën buxhetore të komunave përgjatë 2018.

Për të rritur transparencën buxhetore në komuna është e rëndësishme që:

- Të ndryshohet dhe plotësohet baza ligjore ku:
 - » Të gjitha dokumentet buxhetore, përjashto rregulloret dhe listat, të jenë të publikuara në format të lexueshëm nga kompjuteri (për shembull MS Excel), në mënyrë që të lehtësohet përdorimi i të dhënave;
 - » Të obligohen komunat të publikojnë Kartelën Analitike të Kontos, listat e përfituesve të subvencioneve dhe raportin e auditorit të brendshëm, si dokumente me shumë rëndësi në rritjen e transparencës buxhetore komunale;
- Të obligohen komunat për të aplikuar Udhëzimin administrativ nr. 01/2015 për transparencë në komuna, konkretisht për të publikuar dokumentet buxhetore në ueb-faqe vetëm në vegëzën e buxhetit dhe jo në vegëza të ndryshme.

- Komunat duhet të gjejnë metoda të reja për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjime buxhetore. Rrjetet sociale si dhe anketat e ndryshme mund të ndihmojnë në gjetjen e kanalit më të mirë të komunikimit me qytetarë dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre në organizime të komunave. Po ashtu, nga metodat që mund të përfshihen në Udhëzimin administrativ nr. 01/2015 për transparencë në komuna janë:
 - » Organizimi i fokus grupeve;
 - » Organizimi i katër dëgjimeve buxhetore;
 - » Stimulimet buxhetore;
 - » Formimi i komisioneve këshillëdhënëse të qytetarëve për buxhet;
 - » Anketat me qytetarë;
 - » Përdorimi i platformave online për komente.
- Duhet të publikohen procesverbalet e dëgjimeve buxhetore pasi që ato do të ndikonin që të bëhen hulumtime nga OJQ-të lidhur me nivelin e llogaridhënies nga komuna dhe marrjen parasysh të kërkesave buxhetore. Si rezultat final do të ishte rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në procese buxhetore, ndarja më e drejtë e buxhetit, rritja e besimit të qytetarëve dhe rritja e të hyrave buxhetore.

Anekset

Komuna e Shtimes

| | |
|---|----------|
| Rangimi në indeksin e transparencës 2017: | 1 |
| Numri i pikëve: | 85.5/100 |

Në bazë të Indeksit të Institutit GAP për transparencë buxhetore të komunave 2017, del se Komuna e Shtimes është komuna më transparente. Të gjitha dokumentet e vlerësuara me pikë në indeks janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës në internet dhe pjesa më e madhe janë në formatin “Excel”, i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Po ashtu, Komuna e Shtimes ka të publikuar një raport financiar (TM2 2017) dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2018-2020 në formatin “PDF”, çfarë e bënë më të vështirë përdorimin e informacioneve në këto dokumente nga qytetarët. Komuna e Shtimes e ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore. Po ashtu, komuna e Shtimes e ka të publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe ka organizuar katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2018. Kurse, komuna nuk ka publikuar raportin e auditorit të brendshëm dhe kontratat e nënshkruara në 2017, ku kjo e fundit nuk merr pikë në indeks.

Lidhur me dokumentet shtesë në indeks të cilat tregojnë prirjen e komunës së Shtimes për transparencë buxhetore në 2018, komuna ka publikuar të gjitha ato dokumente. Konkretisht, janë publikuar në ueb-faqen e saj raportet tremujore për gjysmën e parë të vitit dhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione, konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 6. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Shtimes

| Dokumenti | Pikët | | | | Kërkesa |
|---|-----------|-------------|---------------|----------|-------------|
| | Excel | PDF | PDF i skanuar | | |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2017 | 5 | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2017 | - | 3.5 | - | - | |
| Raporti financiar TM 3 për vitin 2017 | 5 | - | - | - | |
| Raporti vjetor financiar për vitin 2017 | 15 | - | - | - | |
| Buxheti i planifikuar për vitin 2018 | 5 | - | - | - | |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 | - | 7 | - | - | |
| Rregullorja për ndarjen e subvencioneve | - | - | 5 | - | |
| Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2017 | 10 | - | - | - | |
| Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2017 | 20 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Raporti i auditorit të brendshëm 2017 | - | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2018 | - | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2018 | - | - | - | - | |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 | - | - | - | - | |
| Kontratat e nënshkruara 2017 | - | - | - | - | |
| Totali | 70 | 10.5 | 5 | - | 85.5 |
| Rangimi në 2016 | 9 | | | | |

Komuna e Gjakovës

| | |
|---|--------|
| Rangimi në indeksin e transparencës 2017: | 2 |
| Numri i pikëve: | 71/100 |

Komuna e Gjakovës në bazë të indeksit për transparencë buxhetore, bënë pjesë në kuartilin e katërt të komunave që kanë prej 59.1 pikë apo më shumë. Pjesa më e madhe e dokumenteve buxhetore janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës në formatin 'Excel', i cili e bënë qasjen dhe përdorimin e këtyre dokumenteve më të lehtë. Ndërsa, ka të publikuara listën e përfituesve të subvencioneve dhe Kartelën Analtike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore në formatin 'PDF', e cila e bënë më të vështirë përdorimin e informacioneve që përmbajnë këto dokumente. Po ashtu, komuna e Gjakovës e ka të publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve dhe ka organizuar më shumë se katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2018. Komuna e Gjakovës nuk e ka të publikuar raportin e auditorit të brendshëm dhe kontratat e nënshkruara të vitit 2017, ku kjo e fundit nuk merr pikë në indeks.

Lidhur me dokumentet shtesë në indeks të cilat tregojnë prirjen e komunës për transparencë buxhetore në vitin 2018, komuna ka të publikuara raportet tremujore financare për gjysmën e parë të vitit dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2020.

Kjo komunë është përgjigjur në kërkesat për qasje në informacione, konform Ligjit për qasje në dokumente publike.

Tabela 7. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Gjakovës

| Dokumenti | Pikët | | | | Kërkesa |
|---|------------------------------|-----------|---------------|----------|-----------|
| | Excel | PDF | PDF i skanuar | | |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2017 | 5 | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2017 | 5 | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 3 për vitin 2017 | 5 | - | - | - | |
| Raporti vjetor financiar për vitin 2017 | 15 | - | - | - | |
| Buxheti i planifikuar për vitin 2018 | 5 | - | - | - | |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 | - | - | - | - | |
| Rregullorja për ndarjen e subvencioneve | - | - | 5 | - | |
| Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2017 | - | 7 | - | - | |
| Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2017 | - | 14 | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Raporti i auditorit të brendshëm 2017 | - | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2018 | - | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2018 | - | - | - | - | |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 | - | - | - | - | |
| Kontratat e nënshkruara 2017 | - | - | - | - | |
| Totali | 45 | 21 | 5 | - | 71 |
| Rangimi në 2016 | Nuk ka qenë pjesë e indeksit | | | | |

Komuna e Mitrovicës

| | |
|---|----------|
| Rangimi në indeksin e transparencës 2017: | 3 |
| Numri i pikëve: | 69.5/100 |

Në bazë të indeksit për transparencë buxhetore, Komuna e Mitrovicës bënë pjesë në kuartilin e katërt që në indeks kanë 59.1 pikë apo më shumë. Dokumentet e vlerësuara me pikë në indeks janë të publikuara në formatin 'Excel', që lejon qasje dhe përdorim më të lehtë të të dhënave të publikuara apo 'PDF', çfarë e bënë më të vështirë përdorimin e informacioneve që përmbajnë dokumentet nga palët e interesuara. Raporti i auditorit të brendshëm është i publikuar në faqen zyrtare të komunës në formatin 'PDF'. Po ashtu, komuna e Mitrovicës ka organizuar më shumë se katër dëgjime buxhetore me qytetarët në lidhje me buxhetin e vitit 2018. Kurse, nuk është publikuar Kartela Analitike e Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore.

Komuna ka publikuar dokumentet shtesë në indeks, të cilat tregojnë prirjen e komunës së Mitrovicës për transparencë buxhetore në vitin 2018. Koncretisht, janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës raportet tremujore financiare për gjysmën e vitit të parë dhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021.

Tabela 8. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Mitrovicës

| Dokumenti | Pikët | | | | Kërkesa |
|---|-----------|-------------|---------------|----------|-------------|
| | Excel | PDF | PDF i skanuar | | |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2017 | - | 3.5 | - | - | |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2017 | - | 3.5 | - | - | |
| Raporti financiar TM 3 për vitin 2017 | - | 3.5 | - | - | |
| Raporti vjetor financiar për vitin 2017 | 15 | - | - | - | |
| Buxheti i planifikuar për vitin 2018 | 5 | - | - | - | |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 | - | 7 | - | - | |
| Rregullorja për ndarjen e subvencioneve | - | - | 5 | - | |
| Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2017 | - | 7 | - | - | |
| Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2017 | - | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Raporti i auditorit të brendshëm 2017 | - | 10 | - | - | |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2018 | - | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2018 | - | - | - | - | |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 | - | - | - | - | |
| Kontratat e nënshkruara 2017 | - | - | - | - | |
| Totali | 30 | 34.5 | 5 | - | 69.5 |
| Rangimi në 2016 | 18 | | | | |

Komuna e Prishtinës

| | |
|---|--------|
| Rangimi në indeksin e transparencës 2017: | 4 |
| Numri i pikëve: | 67/100 |

Komuna e Prishtinës në bazë të indeksit të institutit GAP për transparencë buxhetore bënë pjesë në kuartilin e katërt të komunave që në indeks mbledhin 59.1 pikë apo më shumë. Komuna ka publikuar pjesën më të madhe të dokumenteve buxhetore në faqen zyrtare të saj në formatin 'Excel', që e bënë shumë më të lehtë qasjen dhe përdorimin e të dhënave të publikuara. Kurse, Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 është e publikuar në formatin 'PDF', çfarë e bënë më të vështirë përdorimin e informacioneve që përmbanë ky dokument nga palët e interesuara. Po ashtu, komuna e Prishtinës ka organizuar më shumë se katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2018. Komuna e Prishtinës nuk i ka të publikuara Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore dhe raportin e auditorit të brendshëm. Gjithashtu, komuna nuk i ka të publikuara kontratat e nënshkruara të vitit 2017, që nuk marrin pikë në indeks.

Dokumentet shtesë në indeks që tregojnë prirjen për transparencë në vitin 2018 janë të publikuara në faqen zyrtare të komuns së Prishtinës. Konkretisht, janë të publikuara raportet tremujore financiare për gjysmën e vitit të parë dhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021.

Tabela 9. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Prishtinës.

| Dokumenti | Pikët | | | | |
|---|-----------|-----------|---------------|----------|-----------|
| | Excel | PDF | PDF i skanuar | Kërkesa | |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2017 | 5 | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2017 | 5 | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 3 për vitin 2017 | 5 | - | - | - | |
| Raporti vjetor financiar për vitin 2017 | 15 | - | - | - | |
| Buxheti i planifikuar për vitin 2018 | 5 | - | - | - | |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 | - | 7 | - | - | |
| Rregullorja për ndarjen e subvencioneve | - | 5 | - | - | |
| Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2017 | 10 | - | - | - | |
| Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2017 | - | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Raporti i auditorit të brendshëm 2017 | - | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2018 | - | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2018 | - | - | - | - | |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 | - | - | - | - | |
| Kontratat e nënshkruara 2017 | - | - | - | - | |
| Totali | 55 | 12 | - | - | 67 |
| Rangimi në 2016 | 11 | | | | |

Komuna e Prizrenit

| | |
|---|--------|
| Rangimi në indeksin e transparencës 2017: | 5 |
| Numri i pikëve: | 67/100 |

Komuna e Prizrenit në bazë të indeksit për transparencë buxhetore, bënë pjesë në kuartilin e katërt të komunave, që në indeks kanë 59.1 pikë apo më shumë. Dokumentet buxhetore janë të publikuara në faqen zyrtare të komunës në formatin 'Excel', që mundësojnë qasje dhe përdorim të lehtë të informacioneve të publikuara. Ndërsa, ka të publikuar Kornizën Afatmesme Buxhetore në formatin 'PDF' që e bënë më të vështirë përdorimin e të dhënave nga palët e interesuara. Po ashtu, komuna e Prizrenit ka organizuar katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2018. Komuna nuk e ka publikuar Kartelën Analitike të Kontos, si një ndër dokumentet më të detajuara të shpenzimeve buxhetore, raportin e auditorit të brendshëm dhe kontratat e nënshkruara të vitit 2017, ku kjo e fundit nuk merr pikë në indeks.

Komuna e Prizrenit ka publikuar të gjitha dokumentet shtesë të vendosura në indeks që tregojnë prirjen për transparencë buxhetore në vitin 2018, si: raportet tremujore financiare të gjysmë vitit të parë dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021.

Tabela 10. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Shtimes

| Dokumenti | Pikët | | | |
|---|-----------|-----------|---------------|----------|
| | Excel | PDF | PDF i skanuar | Kërkesa |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2017 | 5 | - | - | - |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2017 | 5 | - | - | - |
| Raporti financiar TM 3 për vitin 2017 | 5 | - | - | - |
| Raporti vjetor financiar për vitin 2017 | 15 | - | - | - |
| Buxheti i planifikuar për vitin 2018 | 5 | - | - | - |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 | - | 7 | - | - |
| Rregullorja për ndarjen e subvencioneve | - | 5 | - | - |
| Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2017 | 10 | - | - | - |
| Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2017 | - | - | - | - |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - |
| Raporti i auditorit të brendshëm 2017 | - | - | - | - |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2018 | - | - | - | - |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2018 | - | - | - | - |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-2021 | - | - | - | - |
| Kontratat e nënshkruara 2017 | - | - | - | - |
| Totali | 55 | 12 | - | - |
| Rangimi në 2016 | 2 | | | |

Komuna e Lipjanit

| | |
|---|--------|
| Rangimi në indeksin e transparencës 2017: | 6 |
| Numri i pikëve: | 62/100 |

Në bazë të indeksit të Institutit Gap për transparencë buxhetore, komuna e Lipjanit bënë pjesë në kuartilin e katërt, që në indeks përfshin prej 59.1 pikë apo më shumë. Pjesa më e madhe e dokumenteve buxhetore janë lehtë të qasshme, pasi që formati i dokumenteve të publikuara është 'Excel'. Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 dhe listat e përfituesve të subvencioneve komunale janë të publikuara në formatin 'PDF' dhe si dokumente të skanuara, çfarë e bënë më të vështirë përdorimin e këtyre informacioneve nga palë e interesuara. Po ashtu, komuna ka organizuar më shumë se katër dëgjime buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2018. Komuna e Lipjanit ka publikuar kontratat e nënshkuara për vitin 2017, ndërsa nuk ka publikuar raportin e auditorit të brendshëm dhe Kartelën Analitike të Kontos si një ndër dokumentet më detajuese të shpenzimeve buxhetore.

Lidhur me dokumentet shtesë në indeks që tregojnë prirjen për transparencë buxhetore në vitin 2018, komuna ka publikuar raportet tremujore te gjysmë vitit të parë dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019-2021.

Tabela 11. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Lipjanit

| Dokumenti | Pikët | | | | |
|---|-----------|----------|---------------|----------|-----------|
| | Excel | PDF | PDF i skanuar | Kërkesa | |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2017 | 5 | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2017 | 5 | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 3 për vitin 2017 | 5 | - | - | - | |
| Raporti vjetor financiar për vitin 2017 | 15 | - | - | - | |
| Buxheti i planifikuar për vitin 2018 | 5 | - | - | - | |
| Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 | - | - | 5 | - | |
| Rregullorja për ndarjen e subvencioneve | - | - | 5 | - | |
| Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2017 | - | 7 | - | - | |
| Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2017 | - | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2018 | 2.5 | - | - | - | |
| Raporti i auditorit të brendshëm 2017 | - | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 1 për vitin 2018 | - | - | - | - | |
| Raporti financiar TM 2 për vitin 2018 | - | - | - | - | |
